



STATUTI

I

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE

"PANOS" LTD SHPK

SH. P.K.

Ne mbështetje të ligjit 7638 datë 19.11.1992
Per shoqerite tregtare sdi dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993

Per rregjistrimin ne rregjistrin tregtare ne te quajturit

Janis Rutles , Jani Garha

Argjires Vegdanocali

me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar shpallim si me poshte vijon:

Neni 1

FORMIMI I SHOQERISE TREGETARE

Formohet shoqeria tregtare e quajtur "PANOS LTD" SHPK me ortakë

1- Argjires Vegdanocalis , dt 1953 banues ne Selanik

2- Janis Rutles , dt 1949 banues ne Selanik

3- Jani Garha dt 1934 banues ne Tirane

Neni 2

QENDRA E SHOQERISE TREGETARE

Qendra e shoqerise eshte ne adresen rruga "Q.Stafa" pl 5 shk4

dhe vendqendrimet e tjera te dyta operative dhe filiale ne te gjithë territorin e vendit si dhe jashte saj me miratimin e organeve perkatese kompetente dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto agjensi.

Neni 3

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike eshte e pakufizuar mbi 10 vjete. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe ose mund te zgjatet kjo kohe me vendimin e Asamblese se ortakëve

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimatrise se kesaj shoqerie eshte si me poshte:
Tregtimi me shumice dhe me pakice i mallrave industriale ushqimore
elektrike elektronike, elektroshtepiske, prodhimeve bujqesore dhe
blegterale, artikujve te ndrushem, pjese kembimi, makineri, pajise
, veprimatri ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brend
dhe jashte vendit, veprimatri ne fushen e ushqimit social, turizem,
hapje e restoranteve bar bufe, kafe etj, hapje e agjensive turistike
brenda dhe jashte vendit, veprimatri me shumice i karburanteve import
ekspert etj.

Neni 5

Shoqeria tregtare mund te ndryshoje emertimin e saj
venqendrimin si dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve
qe do te marrin ortakët ne Asamblene e Ortakeve

Neni 6

KAPITALI FILLESTARE

Kapitali fillestare i shoqerise eshte 100000leke
njeqinde mije leke i vendosur ne masen


1-	Janis Gazhga	10%	ose i tipit DAF 35KO 133 me nr shenies
2-	Janis Kutles	45%	00164362 me ngjyre blu
3-			

Detyrimet e anetarit kundrejt shoqerise jane vetem per
pjesen e kapitalit te derdhur nga ai. Per detyrimet e tjera te
shoqerise anetari nuk mban pergjegjesi. Kapitali i kesaj shoqerie
mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin
ortaket ne Asamblene e Ortakeve.

Neni 7

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te
normave qe permba ky statut si dhe te legjislacionit shqiptare ne
fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e rregjisatrimit ne rregjistrin



tregetare ne Gjykatën e rrethit Tirane dhe pasi te marrin liciencen perkatese nga organi perkates tatimore.

Neni 8

Ortaket e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin .Kjo mund te behet vetem pas nxjerrjes se bilancit te shoqerise per pjesen e fitimit te realizuar.

Neni 9

Mbas rregjistrimit te shoqerise ne Gjykatën e rrethit Tirane te drejtat e anetareve dhe pjeset e tyre shoqerore qe u takojne atyre nga pasuria e shoqerise percakitohen nga cdo anetare, Pjeset e tyre shoqerore perputhen me pjeset e kapitalit te secilit anetare, Cdo anetare mund te kete nje pjese shoqerore. Neqoftese anetari siguron pjese te tjera shoqerore ateherë pjesa e tij rritet ne perputhje me kete,

Pjeset e tij anetari i shoqerise mund mund tua ofroje te treteve neqoftese ai ka derdhur pjesen e kapitalit themelore. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e pjeses shoqerore perpara te treteve,

Mbas blerjes se pjeses shoqerore personi i trete mund te fitoje te drejtat e anetarit te shoqerise neqoftese ai ka njohur me pare te drejtat edhe detyrimet e shoqerise

Bleresi i pjeses shoqerore nuk kerkon modifikimin e kontrates. Derdhja e kapitalit tek drejtori i shoqerise ose ne llogarine rrjedhese behet sipas kushteve te vena nga ortaket.

Pjeset e kapitalit themelatre jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, Ato jane lirisht te transferueshme dhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshortve wsi dhe ndermjet bashkeshortve dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve. Perparesi kane anetaret e shoqerise dhe neqoftese Asambleja e Ortakeve nuk jep pelqimin brenda tre muajve ateherë u ofrohen keto kapitale te treteve,

Neni 10

Emertimi i shoqerise tregetare, kapitali themeltare si dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dehe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 11



Shoqeria private vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrime kontraktore dhe jashte kontraktore. Pronaret 4e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa kufizim.

Neni 12

Administratoret e shoqerise jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje kufizim. Ata kane mundesi q1e te kryejne te gjitha aktet qe i konsiderojne te ligjshme per arritjen e qellimeve te shoqerise, kane te drejte te blejne e te kembejne pasuri te lidhen me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja duke siguruar pjesmarrije per arritjen e qellimeve te shoqerise.

Neni 13

ASAMBLEJA

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja qe vendos per cdo ceshtje qe nuk eshte ne kundersiztim me ligjin. Asambleja duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit. Asamblene e mbledh drejtori ose ata anetare te shoqerise qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen te pakten 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese

Neqoftese asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave ajo ka te drejte te marre vendim vetem ateher kur cdo anetare eshte prezente dhe te cilet nuk kundersiztojne thirrjen e Asamblese.


do anetare ka te drejte te vere ne rendin e dites problemin qe ai deshiron. Per kete duhet te njoftohen anetaret 3 dite perpara, neqoftese per ceshtje te ndryshme anetaret nuk jane lajmeruar ateher ato mund te shqyrtohen vetem kur jane prezente te gjitha anetaret e shoqerise dhe nuk kundersiztojne thirrjen e Asamblese.

Anetaret e asamblese mund te vendosin dhe pa bere mbledhjen e asamblese. Projekt vendimet e propozuara jashte asamblese brenda 8 diteve duhet tu behen te njohura anetareve te tjere. Keta anetare duhet te japin voten e tyre me telefax. Po keshtu per rezultatin e votimit drejtori njofton anetaret 3 dite pas perfundimit te votimit.

Neni 14

TE DREJTAT E ASAMBLESE

- Miratimi i bilancit te shoqerise dhe ndarja e fitimit5
- Perjashtimi i anetarit



-Zgjedhja e drejtorit dhe shkarkimi i tij e drejta e drejtorit për të punësuar

-Aprovimi i kontratave vlera e të cilave nuk kalon të paktën 1/4 e kapitalit themeltar ose të kontratave ndërmjet drejtorit dhe anëtarëve,

-Vendimi për ndërprerjen e aktivitetit, riorganizimi bashkimi me një shoqëri tjetër si dhe krijimi i shoqërive të tjera ekonomike

-Modifikimi i kontratës së shoqërisë

Asambleja vendos për çdo gjë me shumicë votash

Neni 15

E DREJTA E VOTIMIT

Duke u bazuar në kapitalin fillestar anëtarët e shoqërisë kanë këto të drejta votimi.

1-	Argjiris Vegdançollin	45 vota
2-	Janis Kutles	45 vota
3-	Jani Gashga	10 vota

Neni 16

Nuk mund të votojë ai anëtar i shoqërisë që është i interesuar për çështjen që po diskutohet. Në rast se votimet janë të barabarta do të vendoset me short.


Neni 17

DREJTORI

Zgjidhjen e probleme të shoqërisë e bën drejtori i cili përfaqëson Asambleen në një kohë të caktuar. Për zgjedhjen e shkarkimin e tij është e domosdoshme 61% e votave të anëtarëve të Asamblesë. Drejtori i shoqërisë është Z. Jani Gashga. Drejtori përfaqëson shoqërinë para të tjerëve, gjyket si dhe organeve kompetente. Të drejtat e tij në çështje të ndryshme dhe zgjidhjen e tyre drejtori mund t'ia besojë anëtarëve të shoqërisë. E drejta e punësimit i takon drejtorit.

Neni 18

Për modifikimin e kontratës është e domosdoshme 3/4 e Asamblesë. Detyrimet e reja të anëtarëve të shoqërisë mbi detyrimet që përcakton kontrata si dhe cenimi i të drejtave të anëtarit duhet të vendoset vetëm unanim.



Neni 19

MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes se shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punes perve3c dispozitave te parashikuara ne kontraten e punes dhe te parashikura ne legjislacionin perkates

Neni 20

Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit e te sigurimeve shoqerore per te gjithë te punesuarit ne te ndersa keta te fundit jane te detyruar qe te pranojne kete Statut

Neni 21

Te punesuarit ne kete shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas ketij Statuti per moszbatim te ketyre detyrave te ngarkuara dhe demt qe ata i shkaktojne kesaj shoqerie me veprimet ose mosveprimet e tyre

Neni 22

SEKRETI I PUNES

Konsiderohen si sekrete pune te kesaj shoqerie te gjitha akett dhe dokumentat qe jaqne te vendosura si tetilla nga administratoret e kesaj shoqerie.

Neni 23

KONTROLI I BREND SHEM

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me eksperte kontabel te autorizuar ose te emeruar me afat ose pa aft prej administratoreve te shoqerise.

Neni 24

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Veprimtari a ekonomike e shoqerise do te mblyllet ne daten 31 Dhjetor, perveç urdherave te vecanta te administratoreve te shoqerise. Në fund të ç'do periudhe ata nxjerrin bilancin kontabel me rezultatin ekonomike fitim humbje inventar si dhe pergatisin raportin perkates me shkrim.

Neni 25

Me miratimin e bilancit vjetore shoqeria vendos dhe përcakton zhvillimin e fondeve të veçanta për zhvillimin e shoqerise .Pas veçimit të fondeve si më siper dhe pagimit te detyri

meve fiskale të ardhurat neto që mbesin mund të transferoheshin
lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave perkatëse.

Neni 26

Në rast se kapitali i shoqërisë rezulton për shkak të humbjeve
të realizuara më pak se gjysma e kapitalit themelator bashkë
pronarët vendosin brenda 4 muajve nga data e miratimit të
llogaritë mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të
shoqërisë. Nëse prishja nuk shpallet shoqëria zvogëlon kapitalin e
saj në vlerë me të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur pa
u mbuluar nga fondet rezerve.

Neni 27

SHPERNDARJA OSE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria private ndryshon organizimin e saj në formën e
shpërberjes si dhe pushon veprimat në formën e likuidimit
.Për këtë qëllim shoqëria tregtare krijon komisionin e likuidimit i
cili paraqet bilancin e likuidimit. Mbase mbyllet shoqëria ajo kryen të
gjitha dokumentat e nevojshme dhe veprimet e duhura për c
rregjistrimin e saj nga rregjisatri tregtar.

Neni 28

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet
legjislativitetit shqiptar dhe rregullores së brendshme të nxjerre
nga administratoret. Ndryshimet e plotësimet e këtij Statuti bëhen
në të njëjtën mënyrë siç nxirret vete ky Statut. Ndryshimet e bëra
në këtë Statut nuk prekin personalitetin juridik të kësaj shoqërie
tregtare private.

Neni 29

Ky statut pas përpilimit nënshkruhet rregullisht nga
administratoret e saj para noteres dhe merr formë ligjore pas
miratimit të këtij statuti dhe të kësaj shoqërie nga organet
perkatëse Gjykatë e rrethit Tiranë si dhe Zyra e tatimeve

ADMINISTRATORET

A. Vopsha

J. Gazdaj

Kubler